



342 10.3.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1030

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 10.03.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.28

Datë: 03.03.2023


“ Për përdorimin e Fondit të Emergjencave, nga Granti & të Ardhurat”

“Për përballimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit e shkollës 9-vjecare Irfan Hajrullai, e cila është në process rikonstruksioni që zhvillojnë procesin mësimor në shkollën 9-vjecare Demir Gashi”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.342/1 prot.

Peshkopi, më 16.03.2023

Lënda: Kthim vendimi për rishqyrtim.

Bashkisë

DIBËR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikoi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.28 (njëzetetë) datë 03.03.2023, për trajtim me ndihmë shtetërore financiare për dëmtime nga faktorët natyror apo njerëzor, konstatova se :

Në zbatim të ligjit nr.45 datë 18.07.2019, "Për Mbrojtjen Civile", të kreut III, pika 3, shkronja h të VKM nr.329 datë 16.05.2012, të VKM nr.94 datë 22.02.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombetare për Zvogëlimin e Risikut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit, të Udhëzimit nr.263 datë 24.05.2013, 'Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", ku për rrjedhoj :

-Fondet e Emergjencave Civile përdoren për riaftësim të ifrastrukturës kritike në territorin e qeverisjes vendore, si ura, prita malore, rrugë, diga, argjinatura dhe impianteve të trajtimit për ujin e pijshëm apo të ndotur, por jo për transport nxënësish.

Për këto arsye vendimi nr.28 (njëzetetë) datë 03.03.2023, kthehet për rishqyrtim duke kërkuar reflektimin e organit vendor në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 28 Datë 03/03/2023

“Për përdorimin e Fondit të Emergjencave, nga Granti & të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22.12.2022, mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023 I konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.19/1 prot datë 11.01.2023, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 03.03.2023 me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Nga fondi emergjencave i detajuar në buxhetin e vitit 2023 në vlerën prej 9.858.204 (nëntë million e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e katër)lekë të përdoren për përballimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit e shkollës 9-vjecare Irfan Hajrullai, e cila është në process rikonstruksioni që zhvillojnë procesin mësimor në shkollën 9-vjecare Demir Gashi të përdoret vlera prej 630.000(gjashtëqindë e tridhjetë mijë)lekë.

Të pakësohet:

Grupi	Kapitulli	Programi	Artikulli	Shuma(lekë)
00	01	1810	604	630.000


Të shtohet:

Grupi	Kapitulli	Programi	Artikulli	Shuma(lekë)
00	01	9120	604	630.000

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike(Sektori Financës) pranë Bashkisë Dibër.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë 03.03.2023.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava



BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
 Sektori i Financës
PROJEKT- V E N D I M
 Nr. 04 Datë 01/03/2023

“Për Përdorimin e Fondit Emergjencave, nga Granti & Te ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ne vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22.12..2022,mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.19/1prot datë 11.01.2023 :

Kërkojmë:

I .Nga fondi emergjencave i detajuar në buxhetin e vitit 2023 në vlerën prej 9.858.204(Nente milione e teteqind e pesedhjetë e tete mijë e dyqind e kater)leke të përdoren për përballimin e shpenzimeve të transportit për nxenesit e shkolles 9-vjeçare Irfan Hajrullai ,e cila është në proces rikonstruksioni që zhvillojnë procesin mesimor në shkollën 9-vjeçare Demir Gashi të përdoret vlera prej **630.000**(gjashtëqinde e tridhjetë mijë)leke.

Te . Pakësohet:

Grupi	Kapitulli	Programi	Artikulli	Shuma(leke)
00	01	1810	604	630.000

Te . Shtohet

Grupi	Kapitulli	Programi	Artikulli	Shuma(leke)
00	01	9120	604	630.000

II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PER BASHKINE DIBER

P/S/Finances
 Antike TORBA

Drejtori Ekonomik
 Mensur SHEHI


Kryetari i Bashkisë
 Rahim SPAHIU

Ne mungesë dhe në porosi
 Nën Kryetari i Bashkisë
 Rashid DEDA



PREVENTIVI Perlogaritje e shpenzimeve te transportit sipas VKB nr. 16 date 03.03.2021, per periudhen Mars-Qershor 2023

Miratohet
 KRYETARI
 Rahim Spahiu
 Në mungesë dhe me autorizim
 Zyrtarë
 Ruzhdi DEPA
 Kryetari



Perfunesit e shërbimit të transportit, nxenesit e arsimit bazë/mesëm, për distancën nga 2 KM deri 12 KM

Emertimi i Institucionit	Nr. Nxenesve perfunes	FONDI LIMIT	Vlera ne Leke ME TVSH	Perfunesit e shërbimit të transportit, nxenesit e arsimit bazë/mesëm, për distancën nga 2 KM deri 12 KM			
				Nr. Nxenes	Qmimi biletës vajtje - ardhje	Ditë mesimore për periudhen Mars-Qershor 2023	Vlera e shpenzimeve për grupin e nxënësve.
1 Bashkia Diber	140	630.000	-	140	60	75	630.000
TOTALI	140	630.000	-				

Preventivoi
 Valbona Kaloci

